

KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

Sot, më 13.02.2020 në Tiranë, lidhet kjo kontratë shitblerje kuotash ("Kontrata"), ndërmjet palëve:

- **WSI Shpk.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën Rruga Pjeter Bogdani, Pallati 39/1, Ap. 4/4, Tiranë, Shqipëri, regjistruar në regjistrin tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me NUIS L32301006L, përfaqësuar nga administratori znj. Vanessa Sinani ose perfaqesuesi me prokurë, z. Bledar Sinani (këtej e tutje referuar si "*Shitësi*");

dhe

- **Matrix Konstruksion Shpk.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga "Nikolla Jorga", Godina Nr.18/2, Tiranë, Shqipëri, regjistruar në regjistrin tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me NUIS J91306009Q, përfaqësuar nga administratori znj. Ida Mezini; (këtej e tutje referuar si "*Blerësi*").

(këtej e tutje Shitësi dhe Blerësi referohen bashkërisht edhe si "*Palët*" dhe veçmas si "*Pala*")

Kushtet paraprake

- A) Shitësi është ortak dhe zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 55 lekë, e cila përbën 55% (pesëdhjetë e pesë për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë **Blue TDI Shpk.**, me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga "Nikolla Jorga", Godina Nr.18/2 Tiranë, Shqipëri, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me numër unik identifikimi NUIS L91926023K ("*Shoqëria*").
- B) Blerësi është ortak dhe zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 22.5 lekë, e cila përbën 22.5% (njëzet e dy presje pesë) të kapitalit themeltar të së njëjtës Shoqëri.
- C) Shitësi dëshiron të ndajë kuotën e tij dhe të shesë pjesë të saj, përbëse të 10% të kapitalit të Shoqërisë dhe Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi këtë kuotë. Pas ndarjes, Shitësi do të zotërojë në Shoqëri kuotën përbërëse të 45% të kapitalit dhe Blerësi kuotë përbërëse të 10% të tij.

Meqenëse ekzistojnë kushtet paraprake më sipër, Palët pranojnë të lidhin këtë Kontratë Shitblerje (këtej e tutje referuar si "*Kontrata*") sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1 **Kushtet paraprake**

Kushtet paraprake të mësipërme përbëjnë pjesë përbërëse dhe thelbësore të Kontratës.

Neni 2 **Shitja e kuotës**

- 2.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi shet dhe transferon pjesë të kuotës së tij, përbërëse të 10% të kapitalit të Shoqërisë ("Kuota"), të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo kufizim të cfarëdo lloji, në favor të Blerësit.
- 2.2. Pas transferimit të titullit mbi Kuotën nga Shitësi tek Blerësi, Shitësi do të zotërojë në Shoqëri kuotën përbërëse të 45% të kapitalit dhe Blerësi kuotë përbërëse të 10% të tij.
- 2.3. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi, në përputhje dhe në proporcion me Kuotën e blerë, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet të saj sipas kushteve të rëna dakord ndërmjet Palëve.
- 2.4. Me transferimin e Kuotës sipas kësaj Kontrate, kapitali themeltar i Shoqërisë do të zotërohet nga ortakët si më poshtë vijon:
 - o WSI Shpk., zotërues i 1 (një) kuote, e barabartë me 45% (dyzet e pesë për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, me seli në adresën: Rruga Pjeter Bogdani, Pallati 39/1, Ap. 4/4, Tiranë, Shqipëri, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me numër unik identifikimi NUIS L32301006L;
 - o Matrix Konstruksion Shpk., zotërues i 1 (një) kuote, e barabartë me 32.5% (tridhjetë e dy presje pesë për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga "Nikolla Jorga", Godina Nr.18/2, Tiranë, Shqipëri, me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS J91306009Q;
 - o GBI Shpk., zotërues i 1 (një) kuote, e barabartë me 22.5% (njëzet e dy presje pesë për qind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë, me seli në adresën: Njesia Bashkiake nr 2, Rruga Themistokli Gërmenji, prane RTSH, Kati i I, Tiranë, Shqipëri, me numër unik të identifikimit të subjektit NUIS L71423028S.

Neni 3 **Çmimi**

- 3.1 Çmimi i Shitjes për blerjen e Kuotës së Shitësit nga Blerësi do të jetë në vlerën nominale prej 10 Leke (dhjete) ("Çmimi i Shitjes").
- 3.2 Pagesa e Çmimit të Shitjes nga Shitësi tek Blerësi do të kryhet me transferte bankare në llogaritë përkatëse të Palëve, pas nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 3.3 Të gjitha pagesat dhe detyrimet e mundshme sipas parashikimeve të kësaj Kontrate do të jenë në Lek.

Neni 4

Transferimi i Kuotës

- 4.1 Në datën e nënshkrimit, Shitësi do t'i shesë Blerësit dhe Blerësi do të blejë në përputhje me nenin 3 të kësaj Kontrate, Kuoten e Shitësit dhe të gjitha të drejtat e lidhura me të.
- 4.2 Transferimi i titullit të pronësisë mbi Kuotën së bashku me të gjitha të drejtat, përfitimet dhe detyrimet që lidhen me të do të kryhet në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 4.3 Palët do të nënshkruajnë dhe do të sigurojnë të gjitha dokumentet e nevojshme për regjistrimin e rregullt të transferimit të Kuotës në Qendrën Kombëtare të Bisnesit.

Neni 5

Deklarime dhe Garanci të Shitësit

5.1 Përfaqësimet dhe Garancitë e Shitësit

Në momentin që nënshkruhet kjo Kontratë, Shitësi deklaron dhe garanton se:

- a) Nuk ka asnjë pretendim, të tashmë apo të ardhshëm, në lidhje me pronësi mbi Kuotën dhe asnjë pretendim nga asnjë palë e tretë;
- b) Shitësi ka pronësinë e plotë dhe e gjithë Kuota e Shitësit është emetuar në mënyrë të rregullt dhe e paguar plotësisht. Nuk ka asnjë marrëveshje në lidhje me shitjen e Kuotës të Shitësit apo për emetimin e Kuotave të reja;
- c) Në momentin që do t'i transferohet Blerësit, Kuota do të jetë e emëtuar në mënyrë të vlefshme, e paguar plotësisht dhe e lirë nga çdo barrë apo çdo pretendim të mundshëm;
- d) Informacioni, të dhënat dhe dokumentet që përfshihen në këtë Kontratë janë të vërteta, të përditësuara dhe të plota, deri në këtë datë;
- e) Shitësi garanton dhe mban përgjegjësi ligjore se i gjithë informacioni i përfshirë në dokumentat e dorëzuara prej tij është i plotë, i vërtetë, i saktë dhe jo i rremë.

5.3 Përfaqësimet dhe Garantimet e Blerësit

Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se në datën e nënshkrimit, deklaratimet/garancitë e mëposhtme janë dhe do të jenë të vërteta:

- a) Blerësi ka të gjitha kompetencat dhe autoritetin e nevojshëm për të lidhur këtë Kontratë dhe zbatojë detyrimet që rrjedhin prej saj. Kjo Kontratë është e autorizuar dhe nënshkruar nga Blerësi dhe përbën një detyrim të ligjshëm, të vlefshëm dhe detyrues për Blerësin, të zbatueshëm kundrejt tij në përputhje me kushtet e saj;

- b) Kushtet e kësaj Kontrate (1) nuk do të rezultojnë në shkelje të dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për Blerësin apo Shitësin; (2) nuk do të vijnë në kundërshtim apo në shkelje të dispozitave ligjore apo kërkojnë miratim, apo rezultojnë në vendosjen e ndonjë barre, në bazë të marrëveshjeve apo kontratave në të cilat Blerësi është palë ose nga të cilat Blerësi ose ndonjë prej aseteve të tij është i lidhur;
- c) Fondet e nevojshme për pagesën e Çmimit të Shitjes janë në dispozicion të Blerësit ose të angazhuara pa kufizime në emër të tij.
- d) Blerësi nuk ka asnjë informacion apo të dhënë apo fakt apo dokument të ngjashëm me to, për të cilat është në dijeni në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate përpos atyre të vëna në dispozicion nëpërmjet procesverbalit të dorëzimit, për të cilat mund të kishte ndonjë vërejtje apo pretendim në lidhje me administrimin e deritanishëm nga Shitësi në cilësinë e administratorit.

Neni 6 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis Palëve që mund të lindin ose që lidhen me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e kësaj Kontrate, do të zgjidhen në përgjithësi me mirëkuptim midis Palëve.
- 6.2 Nëse zgjidhja e mosmarrëveshjeve të lindura në lidhje me këtë Kontratë nuk arrihet, organi kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 7 **Ligji i zbatueshëm**

Kjo Kontrate hartohet dhe regullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 8 **Përmbajtja e Kontratës dhe Ndryshimet**

Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë mes Palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme në lidhje me objektin e saj. Cdo ndryshim i kësaj Kontrate do të kryhet me akt shkresot dhe do të nënshkruhet nga të dy Palët.

Kjo Kontratë nënshkruhet nga Palët në Tiranë, më datë 13.02.2020.

* * *

Shitësi:

Blerësi:

SINANI VANESSA
WSI Shpk.

Jeta Mezin
Matrix Konstruksion Shpk.

WSI Sh.p.k
L32301006L

